



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT 11. 05. 2023

14-020/04-94-908/23 më

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008) të nenit 13 paragrafit 1 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet fillimi i procedurave të konsultimit publik, për Projekt Rregulloren për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se 1 (një) vit.
2. Organizimi i konsultimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.
3. Konsultimi publik sipas pikës 1 të këtij Vendimi do të zgjatë 30 ditë, nga dita e shpalljes së njoftimit publik për mbajtje të konsultimit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Zyrtarit përgjegjës për koordinimin e konsultimeve publike;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

